

VENDIM
Nr. 118, datë 27.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 541, DATË 18.6.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE
DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE
STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT
EVROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË
PARAANËTARËSIMIT IPA II (2014–2020)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 541, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës së menaxhimit

Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPA II, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.”

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama